



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ

Data \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-MALL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** *“Blerje Automjete për Administratën”*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34100000-8**

- **Automjete**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** *6,453,399.69 (gjashtë milion e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë presje gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh*

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kamëz** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** *Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 82 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin*

*Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.” Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e parashikuar se: Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

## **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet .

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit*

*tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpermjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

## **2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:**

**2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vleres se perlllogaritur te kontrates, të këtij loti. qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates/lotit.**

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasinë e mallrave të furnizuara,
- ose**
- b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasinë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe pikës 4/b, nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur*

*fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata furnizimi, çka rrit besueshmërinë të Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës. Për shkak të rëndësisë që ka vet Autoriteti Kontraktor, llojit të mallit objekt prokurimi, i rëndësishëm për funksionimin e automjeteve të Prokurorisë së Posaçme, me qëllim që të hyjmë në marrëdhënie kontraktuale me operatorë ekonomikë seriozë në treg, me performancë të mirë e të vazhdueshme, aplikojmë marzhin maksimal të vlerës së parashikuar.*

**2.3.2.**Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

**- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë”** ose ekuivalent (e vlefshme);

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

**Argumentim:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

*Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.*

**2.3.3.**Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentim:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

*Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen*

*të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.*

**2.3.4.** Operatori ekonomik duhet të paraqes **katalagun teknik të mjetit (përfshirë foton e mjetit)**, objekt i këtij prokurimi që duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar për pjesët që i përkasin të dhënave teknike të mallit objekt prokurimi, i cili shërben për të mundësuar verifikimin e plotë dhe të qartë të të dhënave të tij, për të garantuar përmbushje e specifikimeve teknike dhe vlerësimin e tyre.

**Argumentim:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40, pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

*Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.*

**2.3.5.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se dorëzimi i mjetit do të shoqërohet me dokumentacionin e regjistrimit të tij në organet përkatëse (DPSHTRR) sipas legjislacionit në fuqi dhe policën e sigurimit vjetor në emër të Autoritetit Kontraktor.

**Argumentim:** *Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjeti do të dorëzohet pranë AK i pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së.*

**2.3.6.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë të garancisë për automjetin e ofruar, në të cilën të jenë përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi, si dhe periudha e garancisë teknike sipas specifikimeve teknike.

**Argumentim:** *Në bazë të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha*

*riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues.*

**2.3.7.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë se automjeti është i ri dhe i papërdorura.

***Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar pasi Autoriteti Kontraktor e vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, gjithashtu ky kriter ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.*

**2.3.8.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që ka servis dhe që garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin për mjetin objekt i prokurimit, gjatë periudhës së garancisë, në servisin e tij /ose një servisi të marrë me qera, apo përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, dhe të specifikojë adresën e servisit, në qoftë se servisi është në pronësi të dorezohet certifikatën e pronësise ose kontratën e qerave/bashkëpunimit

***Argumentimi:** Bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se disponojnë mjediset e përshtatshme të autorizuara për kryerjen e shërbimeve të riparimit brenda periudhës së garancisë.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet teknike, për mallin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike dhe fondi limit janë hartuar nga komisioni i ngritur me Urdhrin **nr. 5462/1, datë 21.05.2026** të Titullari të Autoritetit Kontraktor, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe referuar nevojave specifike të vetë AK për artikujt objekt prokurimi.

Grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit ka marrë parasysh çmimet e tregut, mbështetur në nenin 76 gërma ”b” e VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon: ... b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim...”*.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**